REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M
PËR PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONIN E RREGULLUAR TË PSIKOLOGUT SEZONI VIII

Kujdes: Sigurohuni që të respektoni të gjitha fazat e aplikimit. Pagesa duhet ngarkuar në sistem brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit nga Urdhri Profesional i Psikologut.
- ***Për çdo problematikë lidhur me aplikimin, lutemi t'i drejtoheni Urdhrit Profesional i Psikologut.***
- ***Për çdo problematikë lidhur me pagesën, lutemi të kontaktoni me QSHA.***

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Psikologut, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online gjatë periudhës **16 – 20 Nëntor 2026**, duke përdorur shërbimin "Aplikim për provim shteti" në platformën e-Albania. Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, pasi të hyjnë në platformën e-Albania dhe të përdorin shërbimin "Aplikim për provim shteti", të zgjedhin opsionin "shtetas i huaj" dhe të plotësojnë fushat e kërkuara.

Gjatë aplikimit online për pjesëmarrje në provimin e shtetit, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

1. *Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin respektiv;*
** Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*
2. Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;
3. Vetëm pas njoftimit të pranimit nga Urdhri Profesional, fatura e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, ***brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit nga Urdhri Profesional****.*

Pagesa duhet të ruhet në formatin PDF me emërtesën "pagesa" (linku për kryerjen e pagesës: https://qsha.gov.al/fatura-per-arketim/ Pas ngarkimit në sistem të pagesës, lutemi që kandidatët të qëndrojnë në pritje të email-it të pranimit nga QSHA, si dhe publikimit të kalendarit dhe orarit të pjesëmarrjes në provim.

Kandidatët do të njoftohen në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia dhe me anë të kodit unik të gjurmimit, mund të gjurmojnë në çdo kohë statusin e aplikimit.

• Provimi do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë, ish-ATSH). Kandidati duhet të paraqitet 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me dokument identifikimi (Kartë identiteti ose Pasaportë, dokumenti origjinal).

Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime përtej orarit të publikuar.

• Për informacion më të detajuar lidhur me aplikimin, procedurat dhe rregullat që duhen zbatuar, lutemi të ndiqni linkun e publikuar në faqen www.qsha.gov.al:

https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/Informacion-Lidhur-me-Provimin-e-Shtetit-ne-Profesionet-e-Rregulluara.pdf

Ju urojmë suksese!